

MATEMATIKA

Te ushtrimet 1 - 10 qarkoni përgjigjen e saktë. Secili ushtrim vlerësohet me 1 pikë.

Στις ασκήσεις 1-10 να κυκλώσετε τη σωστή απάντηση. Η κάθε άσκηση έχει 1 μόριο.

- Vlera e $(2^{-2})^2$ është: - Η τιμή της παράστασης $(2^{-2})^2$ είναι:
 - 4
 - 1/4
 - 1/16
 - 16
- Cili nga ekuacionet e mëposhtme nuk ka zgjidhje:

Ποια από τις παρακάτω εξισώσεις δεν έχει λύση;

 - $x+1=0$
 - $x^2+1=0$
 - $x^3+1=0$
 - $x^3-1=0$
- Numri i vlerave të palejuara të shprehjes $y = \frac{2x}{x^2-9}$ është:

Ο αριθμός των μη επιτρεπόμενων τιμών της παράστασης $y = \frac{2x}{x^2-9}$ είναι:

 - 0
 - 1
 - 2
 - 3
- Grafiku i funksionit $y=x^2-1$ pret boshtin OX në:

Η γραφική παράσταση της συνάρτησης $y=x^2-1$ τέμνει τον άξονα σε.

 - 0 pika
 - 1 pikë
 - 2 pika
 - 3 pika
- Perimetri i rrethit është 2π . Sipërfaqja e tij është:

Η περίμετρος ενός κύκλου είναι 2π . Το εμβαδόν του είναι:

 - π
 - 2π
 - 3π
 - 4π
- Numri i rrënjëve reale të ekuacionit $x^2-3x+2=0$ është:

Ο αριθμός των πραγματικών λύσεων της εξίσωσης $x^2-3x+2=0$ είναι:

 - 0
 - 1
 - 2
 - 3
- Brinjët e një trekëndëshi janë 4cm, 6cm dhe 8cm. Brinja më e vogël e një trekëndëshi të ngjashëm me të është 2cm. Sa është perimetri i të dytit?

Οι πλευρές ενός τριγώνου είναι 4cm, 6cm και 8cm. Η μικρότερη πλευρά ενός όμοιου τριγώνου με αυτό είναι 2cm. Πόσο είναι η περίμετρος του δεύτερου τριγώνου;

 - 7
 - 8
 - 9
 - 10
- Një drejkëndësh ka diagonalen 10 dhe një brinjë 8. Sa është sipërfaqja e tij?

Ένα ορθογώνιο έχει τη διαγώνιο 10 και τη μια πλευρά 8. Πόσο είναι το εμβαδόν του;

 - 18
 - 28
 - 48
 - 180
- Nëse $2a-1=-3$, vlera e shprehjes $4a-a^2$ është: - Αν $2a-1=-3$, τότε η τιμή του $4a-a^2$ είναι:
 - 3
 - 3
 - 5
 - 5
- Në një trekëndësh dybrinjënjëshëm këndi në kulm është 30° më i madh se i bazës. Këndi i bazës është:

Σε ένα ισοσκελές τρίγωνο η γωνία στην κορυφή είναι 30° μεγαλύτερη από της βάσης. Η γωνία της βάσης είναι:

 - 40°
 - 50°
 - 60°
 - 80°

Te ushtrimet e mëposhtme arsyetoni përgjigjen tuaj.

Στις παρακάτω ασκήσεις να αιτιολογήσετε την απάντησή σας.

11. Të zgjidhni ekuacionet dhe shprehjet e mëposhtme:

Να λύσετε τις παρακάτω εξισώσεις και τις παραστάσεις:

a) $2 + 8 \div 2 =$ **1 pikë**

b) $(5-8) \cdot 6 - 2 =$ **1 pikë**

c) $1 - \frac{1}{3} + \frac{3}{4} =$ **1 pikë**

d) $2^{-1} \cdot 10 =$ **1 pikë**

e) Për $m = -2$ dhe $n = 2$ gjeni $m^2 - 6n - mn =$ **1 pikë**

f) $x^2(x-1) - x + 1 = 0$ **2 pikë**

g) $x^3 - 2x^2 - x + 2 = 0$ **2 pikë**

12. Jani është sot 15 vjeç dhe Eleni është 13 vjeç. Pas sa vitesh shuma e moshave të tyre do të jetë 42? **2 pikë**

Ο Γιάννης είναι σήμερα 15 ετών και η Ελένη 13 ετών. Μετά από πόσα χρόνια το άθροισμα των ηλικιών τους θα είναι 42;


13. Jepet ekuacioni $x^2 - 2x - 5 = 0$. Të gjeni $\frac{1}{x_1} + \frac{1}{x_2}$ ku x_1 dhe x_2 janë rrënjët e tij. **3 pikë**

14. Shuma e dy numrave të plotë është 26, kurse nëse pjesëtojmë numrin e madh me të voglin herësi është 4 dhe mbetja 1. Të gjeni numrat. **2 pikë**

Το άθροισμα δυο ακέραιων αριθμών είναι 26, ενώ αν διαιρέσουμε τον μεγαλύτερο με τον μικρότερο βρίσκουμε πηλίκο 4 και υπόλοιπο 1. Να βρείτε τους αριθμούς αυτούς.

15. Një katror AEGF gjendet brenda në një katror ABCD, si te figura e mëposhtme. Nëse sipërfaqja e pjesës së hijëzuar është 16 cm^2 , të gjeni x -in. **4 pikë**

Ένα τετράγωνο AEGF βρίσκεται μέσα στο τετράγωνο ABCD, όπως δείχνει το παρακάτω σχήμα. Αν το εμβαδόν του σκιασμένου χωρίου είναι 16 cm^2 , να βρείτε το x .



16. Një kovë është e mbushur deri në mes me ujë. Nëse i shtojmë 2 litra ujë ajo do të mbushet deri në $\frac{3}{4}$. Sa litra ujë merr kova kur është e mbushur plotë? **3 pikë**


Ένας κουβάς είναι μισογεμάτος με νερό. Αν του προσθέσουμε 2 λίτρα νερό τότε θα είναι γεμάτος κατά τα $\frac{3}{4}$. Πόσα λίτρα νερό χωράει ο κουβάς;

- a) 10 b) 8 c) 6 d) 4

17. 5 drejtkëndësja të njëjtë ndodhen brenda katrorit me brinjë 24cm si në figurë. Sa është syprina e secilit prej drejtkëndëshave?

4 pikë

Πέντε ίσα μεταξύ τους ορθογώνια παραλληλόγραμμα είναι τοποθετημένα μέσα σε ένα τετράγωνο πλευράς 24cm, όπως δείχνει το διάγραμμα. Πόσο είναι το εμβαδόν του κάθε ορθογωνίου παραλληλόγραμμου;



- a) 12cm^2 b) 16cm^2 c) 24cm^2 d) 32cm^2
18. Një grup piratësh gjetën një thesar me monedha floriri dhe i ndan monedhat në mënyrë të barabartë. Nëse monedhat do të ishin 50 më pak, secili do të merrte 5 më pak. Nëse piratët do të ishin 4 më pak, atëherë secili prej tyre do të merrte 10 monedha më tepër. Sa monedha do të ishin të gjitha?

4 pikë

Οι πειρατές βρήκαν ένα θησαυρό από χρυσά νομίσματα που τα μοιράστηκαν μεταξύ τους. Ο καθένας πήρε ίσο μερίδιο με τους υπόλοιπους. Αν τα νομίσματα ήταν 50 λιγότερα, τότε ο κάθε πειρατής θα έπαιρνε 5 νομίσματα λιγότερα. Αν οι πειρατές ήταν 4 λιγότεροι, τότε ο καθένας θα έπαιρνε 10 νομίσματα παραπάνω. Πόσα νομίσματα είχε ο θησαυρός;

- a) 100 b) 120 c) 150 d) 250
19. Jepet katërkëndëshi ABCD. Diagonalet AC dhe BD priten në pikën O. Nëse syprina e trekëndëshit AOB është 15cm^2 , e trekëndëshit COD është 10cm^2 dhe syprina e trekëndëshit AOD është 5cm^2 , të gjeni syprinën e katërkëndëshit ABCD. 5 pikë

Δίνεται το τετράπλευρο ABCD. Οι διαγώνιες AC και BD τέμνονται στο σημείο O. Εάν το εμβαδόν του τριγώνου AOB είναι 15cm^2 , του τριγώνου COD είναι 10cm^2 και το εμβαδόν του τριγώνου AOD είναι 5cm^2 , να βρείτε το εμβαδόν του τετράπλευρου ABCD.

- a) 40cm^2 b) 55cm^2 c) 60cm^2 d) 65cm^2
20. Katër skuadra futbollit bëjnë një kampionat duke luajtur secila skuadër vetëm nga një ndeshje me secilën nga të tjerat. Fitorja është 3 pikë, barazimi 1 pikë, humbja 0 pikë. Në fund skuadra A kishte 7 pikë, skuadra B 4 pikë, skuadra C 4 pikë. Sa pikë kishte skuadra D?

4 pikë

Σε ένα τουρνουά ποδοσφαίρου πήραν μέρος 4 ομάδες. Κάθε ομάδα παίζει μόνο έναν αγώνα με τις υπόλοιπες ομάδες. Η κάθε νίκη είναι 3 πόντοι, η ισοπαλία 1 πόντο και η ήττα 0 πόντους. Στο τέλος, η ομάδα A είχε 7 πόντους η ομάδα B είχε 4 πόντους, η ομάδα C είχε 4 πόντους. Πόσους πόντους είχε η ομάδα D;

- a) 0 b) 1 c) 2 d) 3

GJUHA SHQIPE

Djali me dy sy

Larg, shumë larg, në hapësirë ndodhet një planet tamam si Toka. Njerëzit që jetojnë në planet janë tamam si ne, me ndryshimin se ata kanë vetëm një sy. Ata mund të shikojnë larg, shumë larg dhe mund të shikojnë dhe nëpërmjet mureve. Gratë në këtë planet kanë fëmijë ashtu si dhe në Tokë. Një ditë u lind një fëmijë i çuditshëm. Ai kishte dy sy. Babai dhe nëna e tij u mërzitën shumë. Djali ishte një fëmijë i gëzuar. Prindërit e donin dhe u pëlqente të kujdeseshin për të. Por ata ishin të shqetësuar se ai ishte jo i zakonshëm. Ata e çuan atë në shumë doktorë. Doktorët tundnin kokën dhe thonin se ata nuk mund të bënin asgjë.

Ndërsa fëmija rritej, ai krijonte gjithmonë e më shumë probleme. Për arsye se ai nuk mund të shikonte natën, i duhej të mbante një dritë. Kur shkoi në shkollë, ai nuk mund të lexonte aq mirë sa shokët e tij. Mësuesve të tij iu desh që ta ndihmonin dhe më shumë. Ai nuk mund të shikonte në distanca të gjata, kështu që duhet të kishte një teleskop të posaçëm. Me këtë ai mund të shikonte planetet e tjera, si çdokush tjetër. Ngadonjëherë, kur kthehej nga shkolla, ndihej shumë i vetmuar. -“Fëmijët e tjerë i shikojnë gjërat, unë nuk mundem”, - mendonte ai. -“Unë duhet të jem në gjendje të shikoj gjëra, që ata nuk janë në gjendje t’i shikojnë.”

Dhe, një ditë të mrekullueshme, ai zbuloi se mund të shikonte gjëra që të tjerët nuk i shikonin. Ai nuk shikonte në bardhë e zi, si shikonin të tjerët. Ai u tregoi prindërve se si i shikonte gjërat. Ai i nxori prindërit jashtë në oborr dhe u tregoi për zbulimin e tij të mrekullueshëm. Ata u habitën shumë. Gjithashtu dhe shokët e tij u habitën shumë. Ai u tregonte atyre përralla fantastike, përdorte fjalë, që ata kurrë nuk i kishin dëgjuar më parë si: e kuqe, e verdhë...dhe portokalli. Ai fliste për pemë të gjelbra dhe për lule rozë. Ndonjëri donte të dinte si i shikonte gjërat. Ai tregonte tregime të mrekullueshme për dete të thella blu dhe valë, që krijonin shkumë të bardhë. Fëmijëve u pëlqente të dëgjonin përrallat e tij tërheqëse me dragoj. Ata mbeteshin gojëhapur, kur ai përshkruante lëkurën e tyre, sytë dhe frymëmarrjen e tyre të nxehtë.

Një ditë takoi një vajzë. Ata ranë në dashuri. Asaj nuk i bënte përshtypje që ai kishte dy sy. Dhe, më vonë, ai pa se dhe atij nuk i bënte përshtypje. Ai ishte bërë shumë i famshëm. Njerëzit vinin nga gjithë planeti ta dëgjonin të fliste. Ata patën një djalë. Djali ishte si të gjithë fëmijët e tjerë të planetit. Ai kishte një sy.

Të qarkoni alternativën e saktë:

1. Cili ishte dallimi i djalit nga fëmijët e tjerë? 1 pikë

- a) Ishte më një dorë c) Kishte dy sy
b) Kishte vetëm një këmbë d) Kishte dymbëdhjetë gishtërinj

2. Njerëzit e këtij planeti kishin një dhunti : 1 pikë

- a) shikonin dhe nëpërmjet mureve c) kuptonin gjuhën e kafshëve
b) parashikonin të ardhmen d) çfarë preknin e kthenin në ar

3. Çfarë vështirësish kishte djali me dy sy? 1 pikë

- a) nuk dëgjonte c) nuk fliste
b) nuk shikonte në distance të largëta d) nuk fliste dhe nuk dëgjonte

4. Pse prindërit ishin të shqetësuar për të ? Listo tre shembuj nga teksti. 4 pikë

5. Cila ishte mrekullia që i ndodhi djalit? 1 pikë

6. Pse djali u bë i famshëm? Argumentoni përgjigjen tuaj. 4 pikë

7. Gjeni cili grup fjalësh është njësi frazeologjike. 1 pikë

- a) nxorri ne oborr c) larg shume larg
b) aty-këtu d) ngeleshin gojjehapur

8. Fjala ndonjehere është: 1 pikë

- a) e prejardhur c) e përngjitur
b) e përbërë d) e thjeshtë

9. Fjala e nënvizuar në fjalinë 'Me këtë ai mund të shikonte planetet e tjera, si çdokush tjetër.' është: 1 pikë

- a) ndajfolje c) emër
b) përemër d) mbiemër

10. Në cilën kohë janë foljet në fjalinë: "Ai tregonte tregime të mrekullueshme për dete të thella blu dhe valë, që krijonin shkumë të bardhë." 1 pikë

- a) në kohën e tashme c) në kohën e kryer të thjeshtë
b) në kohën e pakryer d) në kohën më se të kryer

11. Në fjalinë e mëposhtme 'Ai tregonte tregime të mrekullueshme për dete të thella blu dhe valë, që krijonin shkumë të bardhë' gjymtyra e nënvizuar është: 1 pikë

- a) përcaktor me drejtim c) rrethanor vendi
b) kundrinor i drejtë d) rrethanor mënyre

12. Fjalja "Pranverë bujëmadshe" është: 1 pikë

- a) njëkryegjymtyrëshe emërore
b) njëkryegjymtyrëshe pavetore
c) njëkryegjymtyrëshe foljore me vetë të përcaktuar
d) njëkryegjymtyrëshe foljore me vetë të përgjithësuar

13. Gjeni cili përdorim i trajtave të shkurtra e të bashkuara është shkruar saktë. 2 pikë

- a) zëri nuk i'u bind c) ja therte vrapit
b) t'i mori fjalët era d) mi tha të tëra

14. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë: 3 pikë

Kriste valtheve kënga e ferrakut të dehur nga vesa e freskia, nga era e plisit, e gjethit dhe e luleve, nga tërë ndryshmëria që kish sjellë ringjallja e dheut, kthimi i jetës.

- a) kriste: _____
b) nga: _____
c) që: _____

15. Gjeni në ç'rasë dhe ç'vetë është trajta e shkurtër në fjalinë e dhënë më poshtë. 2 pikë

Të gjithëve u përgjigjej nga kupa e qelqtë e qiellit të kulluar...

- a) rasa: _____
b) veta: _____

16. Gjeni funksionin sintaksor të fjalëve të nënvizuara në fjalinë: 3 pikë

Të gjithëve u përgjigjej nga kupa e qelqtë e qiellit të kulluar lauresha e padukshme me ca kumbime kambanëzash të arta, varur në fije drite.

- a) të gjithëve: _____
b) lauresha e padukshme: _____
c) drite: _____

17. Në fjalinë: Kriste valtheve kënga e ferrakut të dehur nga vesa.

a) gjeni funksionin e gjymtyrës së nënvizuar: 1 pikë

b) me se është shprehur ajo: 1 pikë

c) formoni një fjalë të prejardhur me fjalën *vesë*: 2 pikë

18. Gjeni llojin e fjalive të nënrenditura në fjalinë e mëposhtme. Bëni skemën e fjalisë së përbërë.

Kur hapeshin mirë e mirë fletët e portave të dritës, hynin në valle lyshtira të shumta shpesësh pendëmurrme, pendëhirtë e pendëshkruar, që ia thoshin sikush në gjuhë të vet.

a) lloji i fjalive të nënrenditura: 4 pikë

b) skema e fjalisë së përbërë: 4 pike

19. Shkruani nje ese argumentuese me temë: *Të ndryshëm, por të barabartë* 10 pike

Κolegji "Frymë Dashurie"
(2018 - 2019)
Κολλέγιο «Πνοή Αγάπης»